



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË**  
**KIBERNETIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2018

**URDHËR**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2018

**PËR**

**SHPLLJE REKRUTIMESH**

Në zbatim të Ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për Nënshkrimin Elektronik” i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, Ligjit nr. 2/2017, “Për Sigurinë Kibernetike”, VKM nr. 141, datë 22.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, Urdhrit nr. 47, datë 12.04.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, në kuadër të implementimit të projektit të përbashkët me UNICEF, “**Safer and Better Internet for Children in Albania**”,

**URDHËR O J:**

1. Shpalljen për rekrutime në faqen zyrtare të Autoritetit ([www.cesk.gov.al](http://www.cesk.gov.al)), për pozicionet, drejtor projekti dhe ekspert për hartim manuali, si më poshtë:

Në kuadër të implementimit të projektit të përbashkët me UNICEF, “Safer and Better Internet for Children in Albania”, AKCESK kërkon të rekrutojë:

**1( Një ) Drejtor projekti**

Drejtor projekti për koordinimin dhe implementimin e projektit mbi sigurinë online “**Safer and Better Internet for Children in Albania**”.

## **Përgjegjësitë :**

- Siguron që të gjitha aktivitetet e projektit të zbatohen në kohë dhe në mënyrë cilësore në përputhje me kërkesat e donatorëve;
- Zhvillon dhe mban planin e aktiviteteve në bashkëpunim me AKCESK dhe UNICEF dhe raporton rregullisht për progresin dhe zbatimin e projektit;
- Menaxhon buxhetin në bashkëpunim të ngushtë me departamentin e financave dhe me drejtuesit e AKCESK;
- Koordinon planifikimin, organizimin dhe implementimin e aktiviteteve me aktorët përkatës në nivel lokal dhe qendror.
- Përgatit raportet periodike të progresit për UNICEF-in sipas orarit të raportimit të dakorduar dhe formatit të raportimit, bazuar në modelet e UNICEF-it, mbështet përgatitjen e raporteve financiare dhe mban evidenca mbi aktivitetet e projektit;
- Kontribuon në zhvillimin e termave të referencës për ekspertët (Manuali i trajnimit të edukatorëve moshatare; hartimi dhe kostimi i strategjisë për sigurinë kibernetike; zhvilluesin IT; Udhëzues për industrinë; etj.) dhe mbikëqyr zbatimin e kontratave në kuadër të projektit;
- Siguron që aktivitetet e projektit të reflektohen dhe komunikohen në kohë dhe në mënyrën e duhur nëpërmjet mediave sociale;
- Ndërton dhe mban platformën/kanalet e mediave sociale për të shfaqur aktivitetet e projektit.
- Ofron ekspertizë për ngritjen e kapaciteteve për stafin e AKCESK në mediat sociale dhe komunikimin miqësor ndaj fëmijëve.
- Trajnon stafin e AKCESK në menaxhimin e platformës së mediave sociale me qëllim vazhdimësinë e punës nga stafi i përgatitur në përfundim të projektit.
- Dokumenton praktikat më të mira.
- Raporton periodikisht te drejtuesit e AKCESK për ecurinë e aktiviteteve të projektit.

## **Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Të ketë mbaruar studimet pasuniversitare, diplomë e nivelit të dytë në fushat: Drejtësi/Shkenca sociale/Siguri kibernetike, /Menaxhim projektësh
- Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në fusha të ngjashme (menaxhim, koordinim dhe komunikim).
- Të ketë njohuri në fushën financiare.
- Të ketë pasur eksperiencë të mëparshëm pune me fëmijët dhe adoleshentet.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të bashkëpunimit në grup.

## **Paraqitja e dokumenteve:**

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 9.08.2018, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Tiranë

ose në adresën e e-mailit: info@cesk.gov.al, këto dokumenta:

- Kërkesë për aplikim;
  - CV;
  - Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
  - Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
  - Fotokopje të dëshmime të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit (nëse ka);
  - Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t'u kontaktuar.
- (Mosparaqitja e plotë e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit).

### **1(Një) Ekspert i jashtëm**

#### **Ekspert për hartimin e manualit të trajnimit, për trajnimin e nxënësve lider.**

Manuali duhet të përmbajë udhëzime dhe këshilla për sigurinë e fëmijëve online si dhe udhëzime për prindërit dhe mësuesit se si të mbrojmë fëmijët gjatë navigimit në internet.

#### **Përgjegjësitë :**

- Harton manualin e trajnimit për trajnimin e nxënësve lider.
- Trajnon nxënësit lider për trajnimin e fëmijëve mbi sigurinë online
- Teston njohuritë e nxënësve lider para dhe pas trajnimit mbi temën.

#### **Produktet dhe materialet**

Eksperti do të paraqesë në gjuhën shqipe/angleze pranë UNICEF dhe AKCESK, manualin e trajnimit për trajnimin e nxënësve lider.

#### **Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Të ketë mbaruar studimet pasuniversitare, diplomë e nivelit të dytë në fushat: Drejtësi/Shkenca sociale/Siguri kibernetike.
- Të ketë eksperience të mëparshme në organizimin e trajnimeve dhe hartimit të manualeve të ngjashëm.
- Të ketë eksperience të mëparshme në koordinim projektsh/aktivitetesh. Vlerësohet eksperiencia e punës në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe specifikiisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të bashkëpunimit në grup.

### **Paraqitja e dokumenteve:**

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 9.08.2018, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Tiranë ose në adresën e e-mailit: [info@cesk.gov.al](mailto:info@cesk.gov.al), këto dokumenta:

- Kërkesë për aplikim;
  - CV;
  - Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
  - Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
  - Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit (nëse ka);
  - Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar.
- (Mosparaqitja e plotë e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit).

### **APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 9 Gusht, 2018.**

Kandidatet duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda këtij afati pranë zyrave të arshivë – protokollit, pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

2. Ngarkohet Znj. Ermela Cekani për publikimin e shpalljeve në faqen zyrtare të institucionit ([www.cesk.gov.al](http://www.cesk.gov.al)).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

**DREJTOR I PERGJITHSHEM**

**Vilma Tomço**